Considerati l'art. 46 (2) (a) del Regolamento (UE) 2016/679 del Parlamento europeo e del Consiglio del 27 aprile 2016 relativo alla protezione delle persone fisiche con riguardo al trattamento dei dati personali nonché alla libera circolazione di tali dati e che abroga la Direttiva 95/46/CE (Regolamento Generale sulla Protezione dei Dati / RGPD) e la legge dell'ordinamento albanese n° 9887 del 10/03/2008 in materia di protezione dei dati personali).

Ciascuna "Autorità competente" di una Parte (in seguito Autorità), di cui all'art. 1 lettera c dell'Accordo tra la Repubblica Italiana e la Repubblica di Albania in materia di sicurezza sociale (in seguito Accordo), applicherà le garanzie specificate nelle Clausole del presente allegato per il trasferimento di dati personali ad un'Autorità dell'altra Parte. Tali garanzie sono vincolanti per le Parti e prevalgono su eventuali obblighi confliggenti esistenti nei rispettivi ordinamenti.

I. Definizioni

Ai fini delle presenti clausole s'intende per:

- (a) **"dati personali"**: qualsiasi informazione riguardante una persona fisica identificata o identificabile ("Interessato") ai sensi dell'Accordo. Si considera identificabile la persona fisica che può essere identificata, direttamente o indirettamente, con particolare riferimento a un identificativo come un nome, un numero d'identificazione, dati relativi all'ubicazione, un identificativo in rete o a uno o più elementi caratteristici della sua identità fisica, fisiologica, genetica, psichica, economica, culturale o sociale.
- (b) **"dati particolari"**: dati personali che rivelano l'origine razziale o etnica, le opinioni politiche, le convinzioni religiose o filosofiche, l'appartenenza sindacale, dati genetici o biometrici intesi ad identificare in modo univoco una persona fisica, nonché dati relativi alla salute, alla vita sessuale o all'orientamento sessuale della persona.
- (c) **"dati penali"**: dati personali relativi a condanne penali e reati o connesse misure di sicurezza.
- (d) **"dati comuni"**: dati personali che non sono particolari oppure penali.
- (e) **"trattamento"**: qualsiasi operazione o insieme di operazioni compiuti su dati personali, con o senza l'ausilio di processi automatizzati, come la raccolta, la registrazione, l'organizzazione, la strutturazione, la conservazione, l'adattamento o la modifica, l'estrazione, la consultazione, l'uso, la comunicazione mediante trasmissione, la diffusione o qualsiasi altra forma di messa a disposizione, il raffronto o l'interconnessione, la limitazione, la cancellazione o la distruzione.
- (f) **"trasferimento"**: invio di dati personali da un'Autorità di una Parte ad un'Autorità dell'altra Parte.
- (g) **"comunicazione ulteriore"**: invio di dati personali da un'Autorità ricevente ad un'altra Autorità dello stesso paese.
- (h) **"trasferimento ulteriore"**: invio di dati personali da un'Autorità ricevente ad un'altra Autorità di un paese terzo o di un'organizzazione internazionale.
- (i) **"profilazione"**: qualsiasi forma di trattamento automatizzato di dati personali consistente nell'utilizzo di dati personali per valutare determinati aspetti personali relativi a una persona fisica.

- (j) **"violazione di dati personali"**: violazione di sicurezza che comporta accidentalmente in modo illecito la distruzione, la perdita, la modifica, la divulgazione non autorizzata o l'accesso a dati personali trasmessi, conservati o comunque trattati.
- (k) **"requisiti di legge applicabili"**: il quadro normativo vigente applicabile a ciascuna Autorità, ivi compresa la normativa sulla protezione dei dati personali.
- (l) **"Autorità di controllo"**: l'autorità pubblica indipendente istituita presso ciascuna Parte, incaricata di sorvegliare l'applicazione della normativa europea e/o nazionale sulla protezione dei dati personali¹.
- (m) **"diritti degli Interessati"**:
- i. **"diritto a ricevere informazioni"**: il diritto di un Interessato a ricevere informazioni sul trattamento di dati personali che lo riguardano in forma concisa, trasparente, intelligibile e facilmente accessibile;
 - ii. **"diritto di accesso"**: il diritto di un Interessato di ottenere la conferma che sia o meno in corso un trattamento di dati personali che lo riguardano e, in tal caso, di ottenere l'accesso ai propri dati personali ed alle caratteristiche del trattamento in corso;
 - iii. **"diritto di rettifica"**: diritto di un Interessato di ottenere la rettifica o l'integrazione dei dati personali inesatti che lo riguardano, senza ingiustificato ritardo;
 - iv. **"diritto di cancellazione"**: il diritto di un Interessato di ottenere la cancellazione dei propri dati personali quando questi non sono più necessari rispetto alle finalità per le quali sono stati raccolti o altrimenti trattati, o quando i dati sono stati raccolti o trattati illecitamente rispetto alle presenti Clausole ed ai requisiti di legge applicabili;
 - v. **"diritto di opposizione"**: il diritto di un Interessato di opporsi in qualsiasi momento, per motivi connessi alla sua situazione particolare, al trattamento di dati personali che lo riguardano, fatti salvi i casi in cui esistano motivi legittimi cogenti per il trattamento che prevalgono sugli interessi avanzati dall'Interessato, tra cui l'accertamento, l'esercizio o la difesa di un diritto in sede giudiziaria;
 - vi. **"diritto di limitazione del trattamento"**: il diritto di un Interessato alla limitazione del trattamento dei propri dati personali quando questi siano inesatti, il trattamento sia illecito, un'Autorità non necessiti più i dati personali rispetto alle finalità per le quali furono raccolti oppure l'Interessato sia in attesa della valutazione di una sua richiesta di opposizione;
 - vii. **"diritto di non essere sottoposto a decisioni automatizzate, compresa la profilazione"**: il diritto di un Interessato a non essere sottoposto a una decisione basata unicamente sul trattamento automatizzato, compresa la profilazione, che produca effetti giuridici che lo riguardano o che incida in modo analogo significativamente sulla sua persona.

II. Ambito di applicazione

Le presenti Clausole si applicano esclusivamente per le finalità perseguite dal Governo della Repubblica Italiana e dal Governo della Repubblica di Albania con l'Accordo in materia di sicurezza sociale, il cui ambito di applicazione, materiale e personale, è specificamente individuato dagli artt. 2 e 3 del medesimo.

Per il perseguimento delle predette finalità le Autorità potranno scambiarsi i seguenti dati

¹ In Italia l'Autorità di controllo indipendente, ai sensi dell'art. 77 dell'RGPD (UE) 2016/679, è il Garante per la protezione dei dati personali, la cui attività è disciplinata dagli artt. 140-bis e successivi del Codice in materia di protezione dei dati personali (D.lgs. 196/2003 e ss.mm.ii.). In Albania il Garante per la Protezione dei dati personali è il Commissario per il Diritto d'informazione e la Protezione dei dati personali, la cui attività è disciplinata dall'art. 29 della L. 9887 del 10/03/2008 e ss.mm.ii. in materia di protezione dei dati personali



personali degli Interessati:

1. dati comuni: dati anagrafici, previdenziali, bancari, fiscali, reddituali, contributivi, retributivi;
2. categorie particolari di dati: dati sanitari;
3. dati penali: condanne penali, reati e connesse misure di sicurezza.

III. Garanzie per la protezione dei dati personali

Per i trattamenti svolti ai sensi del presente Accordo, le Autorità assicurano e sono in grado di comprovare il rispetto dei seguenti principi:

1. Limitazione delle finalità

I dati personali saranno trasferiti tra le Autorità al solo fine di perseguire le finalità indicate al paragrafo II. Le Autorità non effettueranno comunicazioni o trasferimenti ulteriori di dati personali per finalità diverse da quelle sopra indicate, avendo cura di acquisire garanzie appropriate affinché i trattamenti successivi siano limitati a tali finalità, tenuto conto di quanto indicato al punto III.6.

2. Proporzionalità e qualità dei dati

L'Autorità trasferente invierà esclusivamente dati personali adeguati, pertinenti e limitati rispetto alle finalità per le quali sono trasferiti e successivamente trattati, in applicazione del principio di minimizzazione dei dati e, pertanto, di non eccedenza e pertinenza dei dati rispetto alle finalità perseguite. Il trasferimento di dati particolari o penali è ammesso solo se risulta strettamente indispensabile per il perseguimento delle finalità dell'Accordo.

L'Autorità trasferente assicurerà che, per quanto a sua conoscenza, i dati personali che trasferisce sono esatti e, se necessario, aggiornati. Qualora un'Autorità venga a conoscenza del fatto che i dati personali che ha trasferito sono inesatti, ne informerà l'Autorità ricevente, che provvederà alle correzioni del caso.

3. Trasparenza

Ciascuna Autorità fornirà un'informativa generale agli Interessati su:

- (a) identità e dati di contatto del Titolare del trattamento e, ove presente, del Responsabile della protezione dei dati;
- (b) finalità, base giuridica e modalità del trattamento dei dati personali, ivi compreso il loro periodo di conservazione;
- (c) i destinatari ai quali i suddetti dati possono essere trasferiti oppure inviati come comunicazione o trasferimento ulteriore, avendo cura di precisare le garanzie previste e le ragioni dell'invio;
- (d) i diritti degli Interessati ai sensi delle presenti Clausole e dei requisiti di legge applicabili, ivi incluse le modalità di esercizio di tali diritti;
- (e) le informazioni su eventuali ritardi o restrizioni applicabili con riguardo all'esercizio di tali diritti;
- (f) il diritto di presentare reclamo ad un'Autorità di controllo, precisando i relativi dati di contatto, nonché di ricorrere ad un'Autorità giudiziaria². Ciascuna Autorità diffonderà la suddetta informativa sul proprio sito, unitamente all'Accordo. Una copia dell'informativa sarà altresì inserita nelle comunicazioni individuali agli Interessati, così come un rinvio al

² In Italia, l'Autorità giudiziaria competente in materia di protezione dei dati personali, ai sensi dell'art. 79 dell'RGPD, è il Giudice ordinario, come previsto dall'art. 152 del Codice in materia di protezione dei dati personali (D.lgs. 196/2003 e ss.mm.ii.). In Albania, l'Autorità giudiziaria competente per la protezione dei dati personali, in base all'articolo 16 della legge n° 9887 del 10/03/2008 e ss.mm.ii e al Codice di procedura civile, è il Giudice ordinario.

predetto sito.

4. **Sicurezza e riservatezza**

Ciascuna Autorità metterà in atto misure tecniche e organizzative adeguate per proteggere i dati personali ricevuti da accessi accidentali o illegali, distruzione, perdita, alterazione o divulgazione non autorizzata. Le suddette misure includeranno adeguate misure amministrative, tecniche e fisiche di sicurezza. Queste misure dovranno comprendere la classificazione dei dati personali in comuni, particolari e penali, la limitazione dei soggetti ammessi ad accedere ai dati personali, l'archiviazione sicura dei dati personali in funzione della loro tipologia e l'adozione di politiche volte ad assicurare che i dati personali siano mantenuti sicuri e riservati, anche ricorrendo a tecniche di pseudonimizzazione o di cifratura. Per la gestione dei dati particolari e penali dovranno essere adottate le misure di sicurezza più rigorose, prevedendo, tra l'altro, accessi maggiormente selettivi e la formazione specialistica degli addetti.

Qualora un'Autorità ricevente venga a conoscenza di una violazione di dati personali, ne informerà entro 48 ore l'Autorità trasferente e adotterà misure ragionevoli e appropriate per porvi rimedio e minimizzarne i possibili effetti negativi per gli Interessati, ivi inclusa la comunicazione ai predetti, senza ingiustificato ritardo, dell'avvenuta violazione, qualora questa possa comportare un rischio elevato per i loro diritti e le loro libertà.

5. **Modalità per l'esercizio dei diritti**

Ciascuna Autorità adotterà misure appropriate affinché, su richiesta di un Interessato, possa:

- (1) confermare se tratta o meno dati personali che lo riguardano e, in caso affermativo, dare accesso a tali dati, nonché fornire informazioni sul loro trattamento, ivi incluse informazioni sulle finalità del trattamento, le categorie di dati considerate, l'origine ed i destinatari dei dati, il previsto periodo di conservazione e le possibilità di reclamo e ricorso;
- (2) identificare tutti i dati personali del richiedente che ha trasferito all'altra Autorità ai sensi delle presenti Clausole;
- (3) fornire informazioni generali, anche sul proprio sito, in merito alle garanzie applicabili ai trasferimenti all'altra Autorità.

Ciascuna Autorità darà seguito in modo ragionevole e tempestivo a una richiesta di un Interessato riguardante la rettifica, la cancellazione, la limitazione del trattamento o l'opposizione al trattamento dei propri dati personali oppure l'esercizio del diritto a non essere sottoposto a decisioni automatizzate. I recapiti di posta ordinaria o elettronica per l'invio delle predette richieste dovranno essere indicati nell'informativa generale agli Interessati, di cui al punto III.3. sulla trasparenza. Un'Autorità può adottare misure appropriate, come addebitare un contributo spese ragionevole per coprire i costi amministrativi della richiesta o rifiutare di darvi seguito, se questa dovesse risultare manifestamente infondata o eccessiva.

Ciascuna Autorità può ricorrere a procedure automatizzate per perseguire più efficacemente le proprie finalità, a condizione di illustrarne le ragioni e di fornire spiegazioni significative sulla logica utilizzata. In tal caso, dovrà essere acquisito il previo ed esplicito consenso degli Interessati oppure dovrà essere loro riconosciuto il diritto a non essere sottoposti ad un processo decisionale automatizzato. Ad ogni modo, gli Interessati hanno il diritto di far correggere informazioni errate o incomplete sul proprio conto e di chiedere la revisione di una decisione automatizzata tramite un intervento umano.

I diritti degli Interessati possono essere limitati, in misura necessaria e proporzionata in una società democratica, per salvaguardare importanti obiettivi di interesse pubblico riconosciuti dalle Parti nello spirito di reciprocità proprio della cooperazione

internazionale. Rientrano in questo ambito la tutela dei diritti e delle libertà altrui, la sicurezza nazionale, la difesa, la prevenzione, l'indagine, l'accertamento e il perseguimento di reati, nonché lo svolgimento di una funzione di controllo, ispezione o regolamentazione connessa, anche occasionalmente, alle attività esecutive e di vigilanza delle Autorità, operanti nell'esercizio dei pubblici poteri di cui sono investite. Le predette limitazioni, da disciplinare per legge, possono permanere solo finché persiste la ragione che le ha originate.

6. **Comunicazione e trasferimento ulteriore di dati personali**

6.1 *Comunicazione ulteriore di dati personali*

Un'Autorità ricevente potrà procedere alla comunicazione ulteriore di dati personali ad un'altra Autorità dello stesso paese solo previa autorizzazione scritta dell'Autorità trasferente e purché la predetta altra Autorità fornisca le stesse garanzie previste dalle presenti Clausole. Nella richiesta di autorizzazione scritta, l'Autorità ricevente dovrà fornire sufficienti informazioni sulla tipologia di dati che intende comunicare, sulla predetta altra Autorità ricevente, nonché sulla base giuridica, le ragioni e le finalità della comunicazione.

Un'Autorità ricevente potrà procedere, in via eccezionale, alla comunicazione ulteriore di dati personali ad un'altra Autorità dello stesso paese, senza la previa autorizzazione dell'Autorità trasferente, solo se risulti necessario per almeno uno dei seguenti motivi:

- tutela degli interessi vitali di un Interessato o di un'altra persona fisica;
- accertamento, esercizio o difesa di un diritto in sede amministrativa o giudiziaria;
- svolgimento di un'indagine o di un procedimento penale strettamente connessi alle attività per le quali i dati personali sono stati trasferiti.

Nei predetti casi, l'Autorità ricevente informerà previamente l'Autorità trasferente della comunicazione ulteriore fornendo elementi sui dati richiesti, l'altra Autorità richiedente e la pertinente base giuridica. Qualora la previa informazione confligga con un obbligo di confidenzialità, come nel caso di indagini in corso, l'Autorità ricevente dovrà informare l'Autorità trasferente dell'avvenuta comunicazione ulteriore non appena possibile. Nei predetti casi, l'Autorità trasferente dovrà tenere nota delle notifiche in questione e comunicarle alla propria Autorità di controllo su sua richiesta. L'Autorità ricevente si adopererà affinché sia contenuta la comunicazione ulteriore, senza previa autorizzazione, di dati personali ricevuti ai sensi delle presenti Clausole, in particolare facendo valere tutte le esenzioni e le limitazioni applicabili.

6.2 *Trasferimento ulteriore di dati personali*

Un'Autorità ricevente potrà procedere al trasferimento ulteriore di dati personali ad un'altra Autorità di un paese terzo o di un'organizzazione internazionale unicamente previa autorizzazione scritta dell'Autorità trasferente e purché il paese terzo o l'organizzazione internazionale forniscano le stesse garanzie previste nelle predette Clausole. Nella richiesta di autorizzazione scritta, l'Autorità ricevente dovrà fornire sufficienti informazioni sulla tipologia di dati che intende trasferire ulteriormente, sulla predetta altra Autorità ricevente, nonché sulla base giuridica, le ragioni e le finalità del trasferimento ulteriore.

7. **Durata di conservazione dei dati**

Le Autorità conserveranno i dati personali per il tempo previsto dai requisiti di legge applicabili, i quali dovranno prevedere un arco temporale non superiore a quello necessario e proporzionato in una società democratica per le finalità per le quali i dati sono trattati.

8. **Tutela amministrativa e giurisdizionale**

Se un Interessato ritiene che un'Autorità non abbia rispettato le garanzie previste nelle presenti Clausole o che i suoi dati personali siano stati oggetto di trattamento illecito, egli ha il diritto di presentare reclamo ad un'Autorità di controllo e di ottenere tutela giurisdizionale presso un'Autorità giudiziaria, in conformità ai requisiti di legge applicabili nella giurisdizione in cui è stata compiuta la presunta violazione. L'Interessato ha, altresì, il diritto al risarcimento degli eventuali danni subiti.

In caso di controversia o pretesa avanzata da un Interessato nei confronti dell'Autorità trasferente, dell'Autorità ricevente o di entrambe le Autorità con riguardo al trattamento dei dati personali dell'Interessato, le Autorità si daranno reciproca informazione di tali controversie o pretese e si adopereranno per risolvere la controversia o la pretesa in via amichevole in modo tempestivo.

Qualora un Interessato sollevi un rilievo e l'Autorità trasferente ritenga che l'Autorità ricevente non abbia agito compatibilmente con le garanzie previste nelle presenti Clausole, l'Autorità trasferente sospenderà il trasferimento di dati personali all'Autorità ricevente fino a quando non riterrà che quest'ultima abbia risolto la problematica in modo soddisfacente. L'Autorità trasferente informerà sugli sviluppi della questione l'Interessato e la propria Autorità di controllo.

IV. Vigilanza

1. La vigilanza esterna sulla corretta applicazione delle presenti Clausole è assicurata dalle Autorità di controllo.
2. Ciascuna Autorità condurrà periodiche verifiche delle proprie politiche e procedure in attuazione delle presenti Clausole e della loro efficacia. A fronte di una ragionevole istanza da parte di un'Autorità, l'Autorità interpellata riesaminerà le proprie politiche e procedure di trattamento dei dati personali per accertare e confermare che le garanzie previste nelle presenti Clausole siano state efficacemente attuate. Gli esiti del riesame saranno comunicati all'Autorità che ha chiesto il riesame.
3. Qualora un'Autorità ricevente non sia in grado, per qualunque motivo, di attuare efficacemente le garanzie previste nelle presenti Clausole, ne informerà senza ritardo l'Autorità trasferente, nel qual caso questa sospenderà temporaneamente il trasferimento di dati personali all'Autorità ricevente fino a quando quest'ultima non confermerà di essere nuovamente in grado di agire compatibilmente con le predette garanzie. Al riguardo, l'Autorità ricevente e quella trasferente terranno informate le rispettive Autorità di controllo.
4. Qualora un'Autorità trasferente ritenga che un'Autorità ricevente non abbia agito in modo compatibile con le garanzie previste nelle presenti Clausole, l'Autorità trasferente sospenderà il trasferimento di dati personali all'Autorità ricevente fino a quando non riterrà che quest'ultima abbia risolto la questione in modo soddisfacente. Al riguardo, l'Autorità trasferente terrà informata la propria Autorità di controllo.

V. Revisione delle Clausole

1. Le Parti possono consultarsi per rivedere i termini delle presenti Clausole in caso di

cambiamenti sostanziali nei requisiti di legge applicabili.

2. Gli emendamenti entreranno in vigore come specificato all'art. 31 dell'Accordo.
3. Tutti i dati personali già trasferiti ai sensi delle presenti Clausole continueranno a essere trattati applicando le garanzie ivi previste.



Aneksi I

Klauzola për transferimin e të dhënave personale ndërmjet Autoriteteve kompetente të përcaktuara në nenin 29 të Marrëveshjes ndërmjet Republikës Italiane dhe Republikës së Shqipërisë në fushën e sigurimeve shoqërore

Duke marrë parasysh nenin 46 (2) (a) të Rregullores (BE) 2016/679 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 27 prillit 2016, që ka të bëjë me mbrojtjen e personave fizikë në lidhje me përpunimin e të dhënave personale, si edhe me qarkullimin e lirë të këtyre të dhënave dhe që shfuqizon Direktivën 95/46/CE (Rregullorja e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave /RGPD) dhe ligjit shqiptar nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale". Secili "Autoritet Kompetent" i njëjës Palë (që në vijim do të quhet Autoriteti), në zbatim të nenit 1, gërma c, të Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Italisë dhe Republikës së Shqipërisë për sigurimet shoqërore (që në vijim do të quhet Marrëveshja), do të zbatojë garancitë e përcaktuara në pikat e këtij aneksi për transferimin e të dhënave personale të një Autoriteti i Palës tjetër. Këto garanci janë të detyrueshme për Palët dhe mbizotërojnë mbi çdo detyrim konfliktual që ekziston në sistemet e tyre ligjore përkatëse.

I. Përkufizime

Për qëllimet e këtyre klauzolave, nënkuptohet me:

- (a) "**të dhëna personale**": çfarëdoj informacioni në lidhje me një person fizik të identifikuar ose të identifikueshëm ("I interesuari") në përputhje me Marrëveshjen. Konsiderohet i identifikueshëm personi fizik, i cili mund të identifikohet, drejtpërdrejt ose tërthorazi, duke iu referuar në veçanti një të dhëne identifikuese, si emri, një numri identifikimi, të dhënave përkatëse të vendndodhjes, një emri identifikues në rrjet ose njërit apo më shumë elementeve karakteristike të identitetit të tij fizik, fiziologjik, gjenetik, psikik, ekonomik, kulturor apo shoqëror.
- (b) "**të dhëna të veçanta**": të dhëna personale që zbulojnë prejardhjen racore ose etnike, opinionet politike, besimet fetare ose filozofike, anëtarësimin në sindikata, të dhënat gjenetike ose biometrike që përdoren për të identifikuar në mënyrë unike një person fizik, si dhe të dhëna në lidhje me shëndetin e personit, jetën seksuale ose orientimin seksual.
- (c) "**të dhëna penale**": të dhëna personale në lidhje me dënimet dhe veprat penale ose masat e lidhura me sigurinë.
- (d) "**të dhëna të përbashkëta**": të dhëna personale që nuk janë të veçanta ose penale.
- (e) "**përpunim**": çfarëdoj operacioni ose tërësi operacionesh të kryera mbi të dhënat personale, me ose pa ndihmën e proceseve të automatizuara, si, për shembull, mbledhja, regjistrimi, organizimi, strukturimi, ruajtja, përshtatja ose ndryshimi, nxjerrja, konsultimi, përdorimi, komunikimi nëpërmjet transmetimit, shpërndarjes ose çfarëdoj forme tjetër të vënies së tyre në dispozicion, krahasimit ose ndërlidhjes, kufizimit, anulimit ose asgjësimit.
- (f) "**transferim**": dërgimi i të dhënave personale nga një Autoritet i njëjës Palë te një Autoritet i Palës tjetër.
- (g) "**komunikim i mëtejshëm**": dërgimi i të dhënave personale nga një autoritet marrës te një autoritet tjetër i të njëjtit vend.
- (h) "**transferim i mëtejshëm**": dërgimi i të dhënave personale nga një autoritet marrës te një autoritet tjetër i një vendi të tretë ose i një organizate ndërkombëtare.
- (i) "**profilizim**": çfarëdoj forme e përpunimit të automatizuar të të dhënave personale që konsiston në përdorimin e të dhënave personale për të vlerësuar disa aspekte të caktuara personale që kanë të bëjnë me një person fizik.

- (j) **"shkelje e të dhënave personale"**: shkelje e sigurisë që sjell për pasojë, në mënyrë aksidentale ose të paligjshme, asgjësimin, humbjen, ndryshimin, zbulimin e paautorizuar ose aksesin në të dhënat personale të transmetuara, të ruajtura ose, sidoqoftë, të përpunuara.
- (k) **"kërkesat ligjore të zbatueshme"**: kuadri rregullator i zbatueshëm që është në fuqi për secilin Autoritet, duke përfshirë legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.
- (l) **"Autoriteti mbikëqyrës"**: autoriteti publik i pavarur, i ngritur pranë secilës Palë, i ngarkuar me mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit evropian dhe/ose kombëtar për mbrojtjen e të dhënave personale¹.
- (m) **"Të drejtat e të Interesuarve"**:
- i. **"e drejta për të marrë informacione"**: e drejta e një të Interesuari për të marrë informacione mbi përpunimin e të dhënave personale në lidhje me të, në një formë të përmbledhur, transparente, të kuptueshme dhe lehtësisht të aksesueshme;
 - ii. **"e drejta e aksesit"**: e drejta e një të Interesuari për të marrë konfirmimin nëse të dhënat personale në lidhje me të janë duke u përpunuar apo jo dhe, në këtë rast, për të marrë akses në të dhënat e tyre personale dhe në karakteristikat e përpunimit në proces;
 - iii. **"e drejta e korrigjimit"**: e drejta e një të Interesuari për të përfutur korrigjimin ose plotësimin e të dhënave personale të pasakta që kanë të bëjnë me të, pa vonesa të pajustificuara;
 - iv. **"e drejta e fshirjes"**: e drejta e një të Interesuari për të përfutur fshirjen e të dhënave të veta personale, kur këto nuk janë më të nevojshme në lidhje me qëllimet për të cilat ato janë mbledhur ose përpunuar, apo kur të dhënat janë mbledhur ose përpunuar në mënyrë të paligjshme kundrejt këtyre klauzolave dhe kërkesave ligjore në fuqi;
 - v. **"e drejta e kundërshtimit"**: e drejta e një të Interesuari për të kundërshtuar në çdo kohë, për arsye që lidhen me situatën e tij të veçantë, përpunimin e të dhënave personale në lidhje me të, me përjashtim të rasteve kur ekzistojnë arsye të ligjshme detyruese për trajtimin që mbizotërojnë mbi interesat e paraqitura nga i Interesuari, duke përfshirë verifikimin, ushtrimin ose mbrojtjen e një të drejte në gjykatë;
 - vi. **"e drejta për të kufizuar përpunimin"**: e drejta e një të Interesuari për të kufizuar përpunimin e të dhënave të veta personale, kur këto janë të pasakta, përpunimi është i paligjshëm, një Autoritet nuk ka më nevojë për të dhënat personale në lidhje me qëllimet për të cilat ato janë mbledhur ose kur i Interesuari është në pritje të vlerësimit të kërkesës së tij të kundërshtimit;
 - vii. **"e drejta për të mos iu nënshtruar vendimeve të automatizuara, duke përfshirë profilizimin"**: e drejta e një të Interesuari për të mos iu nënshtruar një vendimi të bazuar vetëm në përpunimin e automatizuar, duke përfshirë profilizimin, i cili prodhon efekte juridike që kanë të bëjnë me të ose që ndikojnë në një mënyrë të ngjashme konsiderueshëm mbi personin e tij.

II. Fusha e zbatimit

Këto klauzola zbatohen ekskluzivisht për qëllimet e ndjekura nga Qeveria e Republikës Italiane dhe nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë me Marrëveshjen në fushën e sigurimeve shoqërore, fusha e zbatimit të së cilës, material dhe personal, përcaktohet në mënyrë specifike nga nenet 2 dhe 3 të saj.

Për realizimin e qëllimeve të sipërpërmendura, Autoritetet mund të shkëmbejnë të dhënat personale të të Interesuarve:

¹ Në Itali, autoriteti mbikëqyrës i pavarur, në zbatim të nenit 77 të GDPR (BE) 2016/679, është Garanti për mbrojtjen e të dhënave personale, veprimtaria e të cilit rregullohet nga nenet 140-bis dhe ato vijuese të Kodit për mbrojtjen e të dhënave personale (Dekreti Legjislativ 196/2003 dhe ndryshimet dhe plotësimet e mëvonshme). Në Shqipëri, garant për Mbrojtjen e të Dhënave Personale është Komisioneri për Mbrojtjen e të Drejtës së Informimit dhe veprimtaria e të cilit rregullohet nga neni, 29 të Ligjit 9887 të datës 10.03.2008 të ndryshimeve të mëvonshme në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale.

1. të dhëna të përbashkëta: të dhëna personale, të sigurimeve shoqërore, bankare, tatimore, të të ardhurave, të kontributeve, të pagave;
2. kategori të veçanta të të dhënave: të dhëna shëndetësore;
3. të dhëna penale: dënimet penale, veprat penale dhe masat e sigurisë që lidhen me to.

III. Garancitë për mbrojtjen e të dhënave personale

Për përpunimet e të dhënave që kryhen në përputhje me këtë Marrëveshje, Autoritetet sigurojnë dhe janë në gjendje të provojnë respektimin e parimeve të mëposhtme:

1. Kufizimi i qëllimeve

Të dhënat personale do të transferohen ndërmjet Autoriteteve me qëllimin e vetëm për të përmbushur qëllimet e treguara në paragrafin II. Autoritetet nuk do të kryejnë komunikime ose transferime të mëtejshme të të dhënave personale për qëllime të ndryshme nga ato të treguara më sipër, duke u kujdesur që të marrin garancitë e duhura në mënyrë që përpunimet e mëvonshme të kufizohen në këto qëllime, duke marrë parasysh atë që tregohet në pikën III.6.

2. Proporcionaliteti dhe cilësia e të dhënave

Autoriteti transferues do të dërgojë vetëm të dhëna personale që janë të përshtatshme, të rëndësishme dhe të kufizuara për qëllimet për të cilat ato transferohen dhe përpunohen më pas, në zbatim të parimit të minimizimit të të dhënave dhe, rrjedhimisht, të mostepicës dhe përkatësisë së të dhënave kundrejt qëllimeve të ndjekura. Transferimi i të dhënave të veçanta ose penale lejohet vetëm nëse është ngushtësisht e domosdoshme për përmbushjen e qëllimeve të Marrëveshjes.

Autoriteti transferues do të sigurojë që, nga sa ka vetë dijeni, të dhënat personale që ai transferon, janë të sakta dhe, nëse është e nevojshme, të përditësuara. Nëse një Autoritet merr dijeni për faktin se të dhënat personale që ka transferuar janë të pasakta, ai do të informojë Autoritetin marrës, i cili do të kryejë korrigjimet e rastit.

3. Transparenca

Secili Autoritet do t'u japë informacion të përgjithshëm të Interesuarve në lidhje me:

- (a) identitetin dhe të dhënat e kontaktit të Përgjegjësit për përpunimin e të dhënave dhe, kur është i pranishëm, të Përgjegjësit për mbrojtjen e të dhënave;
- (b) qëllimin, bazën ligjore dhe metodat e përpunimit të të dhënave personale, duke përfshirë periudhën e ruajtjes së tyre;
- (c) marrësit, të cilëve të dhënat e sipërpërmendura mund t'u transferohen ose dërgohen si komunikim ose transferim të mëtejshëm, duke u kujdesur të specifikojnë garancitë e parashikuara dhe arsyet e dërgimit;
- (d) të drejtat e të Interesuarve, në përputhje me këto klauzola dhe me kërkesat ligjore të zbatueshme, duke përfshirë metodat e ushtrimit të këtyre të drejtave;
- (e) informacionet mbi vonesa apo kufizime të mundshme, të zbatueshme në lidhje me ushtrimin e këtyre të drejtave;
- (f) të drejtën për të paraqitur një ankesë pranë një autoriteti mbikëqyrës, duke specifikuar të dhënat përkatëse të kontaktit, si edhe për t'u ankuar pranë një autoritet gjyqësor².

Secili Autoritet do të shpërndajë informacionet e sipërpërmendura në faqen e tij të internetit, së bashku me Marrëveshjen. Një kopje e informacionit do të përfshihet, gjithashtu, në

² Në Itali, autoriteti gjyqësor kompetent për mbrojtjen e të dhënave personale, në zbatim të nenit. 79 i GDPR, është gjyqtari i zakonshëm, siç kërkohet nga neni. 152 i Kodit për mbrojtjen e të dhënave personale (Dekreti Legjislativ 196/2003 dhe ndryshimet dhe plotësimet e mëvonshme). Në Shqipëri, autoriteti gjyqësor kompetent për mbrojtjen e të dhënave personale, në zbatim të nenit 16 të ligjit 9887/2008 sipas Kodit të Procedurës Civile është gjykata.

komunikimet individuale për të Interesuarit, si edhe një referencë në faqen e internetit të sipërpërmendur.

4. Siguria dhe konfidencialiteti

Secili Autoritet do të zbatojë masat e duhura teknike dhe organizative për të mbrojtur të dhënat personale të marra nga akseset aksidentale ose të paligjshme, asgjësimi, humbja, ndryshimi ose zbulimi i paautorizuar. Masat e sipërpërmendura do të përfshijnë masa të përshtatshme administrative, teknike dhe fizike të sigurisë. Këto masa duhet të përfshijnë klasifikimin e të dhënave personale në të dhëna të zakonshme, të veçanta dhe penale, kufizimin e subjekteve të pranuar për të hyrë në të dhënat personale, ruajtjen e sigurt të të dhënave personale sipas llojit të tyre dhe miratimin e politikave që synojnë të sigurojnë që të dhënat personale mbahen të sigurta dhe konfidenciale, duke përfshirë përdorimin e teknikave të pseudonimit ose enkriptimit. Për menaxhimin e të dhënave të veçanta dhe penale duhet të merren masa sigurie më rigorozë, duke përfshirë, ndër të tjera, aksesë më selektive dhe trajnim të specializuar të punonjësve.

Në rast se një autoritet marrës merr dijeni për një shkelje të të dhënave personale, ai do të informojë Autoritetin transferues brenda 48 orëve dhe do të marrë masat e arsyeshme dhe të përshtatshme për ta korrigjuar atë dhe për të minimizuar efektet e mundshme negative për të Interesuarit, duke përfshirë komunikimin me të lartpërmendurit, pa vonesa të pajustificueshme, në lidhje me shkeljen, nëse kjo mund të sjellë për pasojë një rrezik të lartë për të drejtat dhe liritë e tyre.

5. Mënyrat e ushtrimit të të drejtave

Secili Autoritet do të marrë masat e duhura që, me kërkesë të një të Interesuari, të mundet:

(1) të konfirmojë nëse përpunon ose jo të dhënat personale në lidhje me të dhe, nëse po, të japë akses në të dhëna të tilla, si edhe të japë informacione mbi përpunimin e tyre, duke përfshirë informacionin për qëllimet e përpunimit, kategoritë e të dhënave të marra në konsideratë, prejardhjen dhe marrësit e të dhënave, periudhën e parashikuar të ruajtjes dhe mundësitë e ankesës dhe ankimit;

(2) të identifikojë të gjitha të dhënat personale të aplikantit, i cili ia ka transferuar Autoritetit tjetër sipas këtyre Klauzolave;

(3) të japë informacione të përgjithshme, edhe në faqen e tij të internetit, në lidhje me garancitë e zbatueshme për transferimet tek Autoriteti tjetër.

Secili Autoritet do t'i përgjigjet në mënyrë të arsyeshme dhe në kohë një kërkesë të një të Interesuari në lidhje me korrigjimin, anulimin, kufizimin e përpunimit ose kundërshtimin e përpunimit të të dhënave të veta personale ose ushtrimin e së drejtës për të mos iu nënshtruar vendimeve të automatizuara. Të dhënat e kontaktit të postës së zakonshme ose asaj elektronike për dërgimin e kërkesave të sipërpërmendura duhet të tregohen në informacionin e përgjithshëm për të Interesuarit, sikurse parashikohen në pikën III.3. mbi transparencën. Një Autoritet mund të zbatojë masat e duhura, si, për shembull, vendosjen e një tarife të arsyeshme për të mbuluar kostot administrative të kërkesës ose refuzimin për ta ndjekur atë, nëse kjo do të rezultonte haptazi si e pabazuar ose e tepruar.

Secili Autoritet mund të përdorë procedurë të automatizuara për të përbushur në mënyrë më efektive qëllimet e veta, me kusht që të ilustrojë arsyet dhe të japë shpjegime të rëndësishme në lidhje me logjikën e përdorur. Në këtë rast, duhet të merret pëlqimi paraprak dhe i qartë i palëve të interesuara ose duhet të njihet e drejta për të mos iu nënshtruar një procesi vendimmarrjeje të automatizuar. Sidoqoftë, të Interesuarit kanë të drejtë të korrigjojnë informacionet e pasakta ose jo të plota në lidhje me ta dhe të kërkojnë rishikimin e një vendimi të automatizuar nëpërmjet një ndërhyrjeje njerëzore.

Të drejtat e të Interesuarve mund të kufizohen, në një masë të nevojshme dhe proporcionale në një shoqëri demokratike, për të mbrojtur objektiva të rëndësishëm me interes publik të

njohura nga Palët, në frymën e reciprocitetit të duhur për bashkëpunimin ndërkombëtar. Përfshihen në këtë kuadër mbrojtja e të drejtave dhe lirive të të tjerëve, siguria kombëtare, mbrojtja, parandalimi, hetimi, zbulimi dhe ndjekja penale e krimeve, si dhe kryerja e një funksioni kontrolli, inspektimi ose rregullimi, të cilët janë të lidhur, qoftë edhe rastësisht, me veprimtaritë e ekzekutimit dhe të mbikëqyrjes së Autoriteteve, që veprojnë në ushtrimin e kompetencave publike të cilat u janë ngarkuar atyre. Kufizimet e sipërpërmendura, të rregulluara me ligj, mund të vazhdojnë të ekzistojnë vetëm për aq kohë sa ekziston arsyeja që i ka lindur ato.

6. Komunikimi dhe transferimi i mëtejshëm i të dhënave personale

6.1 *Komunikimi i mëtejshëm i të dhënave personale*

Një Autoritet marrës mund të vazhdojë me komunikimin e mëtejshëm të të dhënave personale drejtuar një Autoriteti tjetër të të njëjtit vend vetëm me autorizimin paraprak me shkrim të Autoritetit transferues dhe me kusht që Autoriteti tjetër i sipërpërmendur të japë të njëjtat garanci të parashikuara nga këto Klauzola. Në kërkesën për autorizim me shkrim, Autoriteti marrës duhet të japë informacione të mjaftueshme për llojin e të dhënave që synon të komunikojë, për Autoritetin tjetër marrës të sipërpërmendur, si edhe për bazën ligjore, arsyet dhe qëllimet e komunikimit.

Autoriteti marrës do të mundet të vazhdojë, në mënyrë të jashtëzakonshme, me komunikimin e mëtejshëm të të dhënave personale një Autoriteti tjetër të të njëjtit vend, pa autorizimin paraprak të Autoritetit transferues, vetëm nëse është e nevojshme për të paktën një nga arsyet e mëposhtme:

- mbrojtjen e interesave jetike të një pale të interesuar ose të një personi tjetër fizik;
- verifikimin, ushtrimin ose mbrojtjen e një të drejte në një kontekst administrativ ose gjyqësor;
- kryerja e një hetimi ose një procedimi penal të lidhur ngushtë me veprimtaritë për të cilat janë transferuar të dhënat personale.

Në rastet e sipërpërmendura, Autoriteti marrës do të informojë paraprakisht Autoritetin transferues për komunikimin e mëtejshëm duke dhënë elemente mbi të dhënat e kërkuara, Autoritetin tjetër kërkues dhe bazën ligjore përkatëse. Nëse informacioni paraprak bie ndesh me detyrimin e konfidencialitetit, si në rastin e hetimeve në zhvillim e sipër, Autoriteti marrës duhet të informojë Autoritetin transferues për komunikimin e mëtejshëm sa më shpejt që të jetë e mundur. Në rastet e sipërpërmendura, autoriteti transferues duhet të mbajë shënim për njoftimet në fjalë dhe t'ia komunikojë ato Autoritetit Mbikëqyrës me kërkesën e tij. Autoriteti marrës do të përpiqet të sigurojë që të përmbahet komunikimi i mëtejshëm, pa autorizim paraprak, i të dhënave personale të marra në përputhje me këto Klauzola, në mënyrë të veçantë duke zbatuar të gjitha përjashtimet dhe kufizimet e zbatueshme.

6.2 *Transferimi i mëtejshëm i të dhënave personale*

Një Autoritet marrës mund të vazhdojë me transferimin e mëtejshëm të të dhënave personale te një Autoritet tjetër i një vendi të tretë ose një organizate ndërkombëtare, vetëm me autorizimin me shkrim të Autoritetit transferues dhe me kusht që vendi i tretë ose organizata ndërkombëtare të sigurojë të njëjtat garanci që parashikohen në Klauzolat e sipërpërmendura. Në kërkesën për autorizim me shkrim, Autoriteti marrës duhet të japë informacion të mjaftueshëm për llojin e të dhënave që synon të transferojë më tej, për Autoritetin tjetër marrës të sipërpërmendur, si edhe për bazën ligjore, arsyet dhe qëllimet e transferimit të mëtejshëm.

7. **Kohëzgjatja e ruajtjes së të dhënave**

Autoritetet do të ruajnë të dhënat personale për kohën e parashikuar nga kërkesat ligjore në fuqi, të cilat duhet të parashikojnë për një periudhë kohore që nuk e kalon atë të nevojshme dhe proporcionale në një shoqëri demokratike për qëllimet për të cilat përpunohen të dhënat.

8. **Mbrojtja administrative dhe gjyqësore**

Nëse një i Interesuar beson se një autoritet nuk i ka respektuar garancitë e parashikuara në këto Klauzola ose se të dhënat e tij personale t'j jenë nënshtruar përpunimit të paligjshëm, ai ka të drejtë të ankohet pranë një Autoriteti mbikëqyrës dhe të marrë mbrojtje gjyqësore nga një Autoritet gjyqësor, në përputhje me kërkesat ligjore të zbatueshme në juridiksionin në të cilin ka ndodhur shkelja e pretenduar. I interesuari, gjithashtu, ka të drejtën e kompensimit për çdo dëm të pësuar.

Në rast të një mosmarrëveshjeje ose pretendimi të paraqitur nga një i Interesuar kundër Autoritetit transferues, Autoritetit marrës ose të dy Autoriteteve në lidhje me përpunimin e të dhënave personale të të Interesuarit, autoritetet do t'i japin njëri-tjetrit informacione mbi këto mosmarrëveshje ose pretendime dhe do të angazhohen për të zgjidhur mosmarrëveshjen ose pretendimin në mënyrë miqësore në kohën e duhur.

Nëse një i Interesuar ngre një kritikë dhe Autoriteti transferues vlerëson se Autoriteti marrës nuk ka vepruar në përputhje me garancitë e parashikuara në këto Klauzola, Autoriteti transferues do ta pezullojë transferimin e të dhënave personale tek Autoriteti marrës derisa të vlerësojë se ky i fundit e ka zgjidhur problemin në mënyrë të kënaqshme. Autoriteti transferues do të informojë të Interesuarin dhe Autoritetin e tij mbikëqyrës për zhvillimet e çështjes.

IV. Mbikëqyrja

1. Mbikëqyrja e jashtme e zbatimit të drejtë të këtyre Klauzolave sigurohet nga autoritetet mbikëqyrëse.
2. Secili Autoritet do të kryejë rishikime periodike të politikave dhe procedurave të tij në zbatimin e këtyre Klauzolave dhe efektivitetit të tyre. Me një kërkesë të arsyeshme nga një Autoritet, Autoriteti të cilit i është drejtuar kërkesa do të rishqyrtojë politikën dhe procedurat e tij të përpunimit të të dhënave personale për të verifikuar dhe konfirmuar se garancitë e parashikuara në këto Klauzola janë zbatuar në mënyrë efektive. Rezultatet e rishikimit do t'i komunikohen Autoritetit që ka kërkuar rishqyrtimin.
3. Në rast se një Autoritet marrës nuk është në gjendje, për çfarëdolloj arsyeje, të zbatojë efektivisht garancitë e parashikuara në këto Klauzola, ai do të informojë pa vonesë Autoritetin transferues, në këtë rast ai do të pezullojë përkohësisht transferimin e të dhënave personale tek Autoriteti marrës. derisa ky i fundit të konfirmojë se është sërish në gjendje të veprojë në përputhje me garancitë e sipërpërmendura. Në lidhje me këtë, autoritetet pritëse dhe transferuese do të mbajnë të informuara autoritetet e tyre mbikëqyrëse përkatëse.
4. Në rast se Autoriteti transferues vlerëson se Autoriteti marrës nuk ka vepruar në një mënyrë të pajtueshme me garancitë e parashikuara në këto Klauzola, Autoriteti transferues do ta pezullojë transferimin e të dhënave personale tek Autoriteti marrës, derisa të gjykojë se ky i fundit e ka zgjidhur çështjen. në mënyrë të kënaqshme. Në lidhje me këtë, Autoriteti transferues do ta informojë vazhdimisht Autoritetin e vet mbikëqyrës.

V. Rishikimi i Klauzolave

1. Palët mund të konsultohen për të rishikuar kushtet e këtyre Klauzolave në rast ndryshimesh

materiale në kërkesat ligjore të zbatueshme.

2. Ndryshimet do të hyjnë në fuqi sikurse përcaktohet në nenin. 31 të Marrëveshjes.
3. Të gjitha të dhënat personale të transferuara tashmë në përputhje me këto klauzola do të vazhdojnë të përpunohen duke zbatuar garancitë e parashikuara në to.





19PDL0095290